

Nr. Ref. BD-212/1

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, Rregullore Nr. 07/2023 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Udhëzuesi për lirin e asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpatorët apo Shfrytëzuesit e Paligjshëm, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 21 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen rekomandimet e Menaxhmentit sipas rezultateve të qiradhënies përmes shpalljes publike të datës 25.09.2024 sipas listës së bashkangjitur.
- II. Ky vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin nga Menaxhmenti për shqyrtimin e rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e asetëve përmes shpalljes publike sipas rezultateve të datës 25.09.2024.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Prandaj, dhënia eventuale me qira e asetëve në shtojcë do të shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSH), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet e likuidimit, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.


Kontratat e qirasë për asetet e ndërmarrjeve në likuidim nënshkruhen nga Kryesuesit e Autoriteteve të Likuidimit sipas autorizimeve të parapara në Shtojcën e ligjit të AKP-së.

Duke marrë parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 21 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 25 shtator 2024

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së-njësia	Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë	Lloji i Asetit	Qiradhënie Mujoze/Vjetore	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Çmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit të fundit	Sipërfaqja m²	Çmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit për m2	Çmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit për ar	Çmimi i ofertës më të lartë të pranuar m2	Çmimi i ofertës më të lartë të pranuar ar	Numri i Ofertave	Vendimet e Bordit	A ka të angazhuar momentalisht sigurim për asetin PO/JO	Shuma mujore e pageses së Sigurimit të asetit	Koment / Vrejtje	
122	Peje	NSH Virshinia - Hapësire për zyra - kati 2 i objektit të ndërmarrjes	Pellumb Hoda	Depo	Qiradhënie e Mujoze	Rr. Skënderbeu, Gjakovë	DE 380-2024			1,160.00	€ 0.33		€ 0.07	€ 80.00	2	Refuzim	Po	€ 3,680.00	Janë të angazhuar 4 roje, ish punetore të Ndermarrjes për të siguruar të gjithë hapësirën edhe objektet e NSH Virshinia	
123	Peje	NSH Ening - Objekti i administratës	Muse Gërimi	Objekt i Administratës	Qiradhënie e Mujoze	Rr. Vëllezërit Frashëri p.n. - Gjakovë	DE 382-2024	3	770.00	141.00	€ 2.77		€ 3.38	€ 477.00	2	Aprovim	Jo			
125	Peje	KB Liria - Tokë Bujqësore ngastrat Parcela 30-Q 6584m² nga 11813m², 31-Q 5913m² nga 14578m², 32-Q 13373m² nga 31335m², 32-Q 18097m² nga 13488m², 33-Q 4791m² nga 6265m², 65-Q 7521m², 65-Q 6040m², 66-Q 9300m², 67-Q 6432m² nga 12940m² dhe parcela 67-2 19312m²	Agron Deschenger	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	ZK Stup	DE 384-2024			99,763.00		€ 0.66		€ 1.00	€ 1,000.00	2	Aprovim	JO	Ky aset është tenderuar edhe më herët por nuk kemi pranuar oferta	
131	Peje	NSH Virshinia- Depo pas administratës	Muse Gërimi	Depo	Qiradhënie e Mujoze	Afer magjistrates Gjakovë - Prizren	DE 380-2024		165.00	750.00	€ 0.52		€ 0.54	€ 407.00	5	Aprovim	Po	€ 3,680.00	Duke marr parasysh që aseti del për herë të katërt në tender dhe tani çmimi i ofertës është më i lartë në krahasim me ofertat e mësheshmë, komisioni rekomandon aprovimin e çmimit i ofertës	
132	Peje	NSH Deva Zyrtar e administratës KB Gurakoc Parcelat nr 155-2, 155-3, 155-4, 155-5, 155-6, 155-7, 155-9, 155-10, 155-11, 155-12, 155-13, 155-14, 155-15, 155-16, 155-17, 155-18, 155-19, 155-20, 155-21, 155-22 në ZK Gurakoc	Drilon Leti	Objekt i Administratës	Qiradhënie e Mujoze	Qendra e Qytetit - Gjakovë	DE 383-2024	2	1,212.00	343.00	€ 3.01		€ 3.41	€ 1,170.00	1	Aprovim	Jo			
134	Peje	NSH Virshinia, Objekti nr. 2 mes furrave të cent	Lorik Balaj	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	ZK Gurakoc, Istog	DE 381-2024	1	€ 4,200.00	10,114.00		€ 0.89		€ 14.04	€ 1,420	2	Aprovim	JO		
135	Peje	NSH Virshinia, Objekti nr. 2 mes furrave të cent	Adhurim Harazja	Objekt	Qiradhënie e Mujoze	Rr. Skënderbeu, Gjakovë	DE 380-2024		220	450.00	€ 0.55		€ 1.04	€ 470.00	2	Aprovim	Po	€ 3,680.00	Janë të angazhuar 4 roje, ish punetore të Ndermarrjes për të siguruar të gjithë hapësirën edhe objektet e NSH Virshinia	
136	Peje	NSH Ereniku Prodhimaria Primare Parcela nr 1394-Q, ZK Jahoc	Besnik Shpija	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	Qabrat - Gjakovë	DE 379-2024			10,087.00		€ 0.79		€ 3.48	€ 351.00	5	Aprovim	JO		
139	Prishtine	NSH Kosovarja	Benita Shala	Lokal	Qiradhënie e Mujoze	Prishtine	DE393/2024	1	€ 265	53	€ 4.00		€ 8.83	€ 468	7	Aprovim	JO			
140	Prishtine	NSH Kosovarja	Benita Shala	Lokal	Qiradhënie e Mujoze	Prishtine	DE393/2024	1	€ 120.00	24	€ 10.00		€ 10.13	€ 243	7	Aprovim	JO			
141	Prishtine	Ratar- njësia 3	Osman Berisha	P-73414042-01603-Q	Qiradhënie Vjetore	Zona kadastrale Ulapitellë	DE 397-2024	6	€ 1.25	2,460		€ 11.90		€ 24.39	€ 600.00	1	Aprovim			
143	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine - Njësia 5, Zyra nr 302	Drilon Derguti	Zyre	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	-	51	19	€ 10.46		€ 8.42	€ 160.00	2	Refuzim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
144	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 5, Zyra nr 317	Osman Berisha	Zyre	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	-	-	20	€ 10.46		€ 8.00	€ 160.00	1	Refuzim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
145	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 7, Zyra nr 318	Drilon Derguti	Zyre	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	-	-	20	€ 10.46		€ 9.00	€ 180.00	1	Refuzim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
146	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 8, Zyra nr 321	Drilon Derguti	Zyre	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	-	-	15	€ 10.46		€ 10.33	€ 155.00	1	Aprovim	N/A	Komisioni rekomandon Aprovimin e Ofertës duke u bazuar në çmimin e paraftit me mesataren krahasuese		
147	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 9, Zyra nr 322	Vesa Sahatpju	Zyre	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	-	-	23	€ 10.46		€ 10.87	€ 250.00	2	Aprovim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
149	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 11, Kuzhina e punetoreve - Depo	Vijolca Llujqi	Depo	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024		€ 205.00	76	€ 9.56		€ 3.97	€ 302.00	1	Refuzim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
150	Prishtine	NewCo Grand Hotel Prishtine- Njësia 12, Restorant/Taverna	Fadi Puhaili	Lokal	Qiradhënie e Mujoze	Sheshi "Zahir Pajaziti" Prishtine	DE 396-2024	1	€ 3,052.00	549	€ 10.31		€ 5.52	€ 3,030.00	1	Refuzim	N/A	Ofertuesit e Shërbimeve të NewCO Grand Hotel		
151	Prishtine	Njësia 14- KB Kosova Ulpjan	Labinot Dedushi	P-73409082-00366-Q	Qiradhënie e Mujoze	ZK Suhodoll	DE 391-2024	N/A	N/A	9,445	€ 10.54		€ 0.74	€ 70.00	2	Refuzim				
152	Prishtine	Njësia 15- KB Kosova Ulpjan	Mentor Zejnullahu	P-71409044-00421-Q	Qiradhënie e Mujoze	ZK Ulpjan	DE 391-2024	N/A	N/A	1,746	€ 10.54		€ 0.57	€ 10.00	1	Refuzim				
153	Prishtine	Njësia 16- KB Kosova Ulpjan	Mentor Zejnullahu	P-71409044-00421-Q	Qiradhënie e Mujoze	ZK Ulpjan	DE 391-2024	N/A	N/A	763	€ 10.54		€ 0.39	€ 3.00	1	Refuzim				
207	Prizren	PR2006 NSH NBI Suhareka, Suhareka Tokë Bujqësore në Sallagradhë 4	Zef Gruda	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	ZK Sallagradhë, Suharekë	DE 390-2024	0		56,807		€ 0.65		€ 0.62	€ 350.00	1	Aprovim	JO	Komisioni ka marr për bate se dallimim i ofertës me çmimin i ofertës është vetëm 0.03 cent më i ulët andaj ka konsideruar se është dallim shumë i vogël dhe ka rekomanduar aprovimin e ofertës më të lartë.	
208	Prizren	PR2006 NSH NBI Suhareka, Suhareka Parcela 1284-Q në ZK Sallagradhë	Beqir Elezi	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	ZK Sallagradhë, Suharekë	DE 390-2024	0		619		€ 0.76		€ 8.08	€ 50.00	1	Aprovim	JO		
219	Prizren	PR209 NSH NBI Laveri Biletori, Prizren Tokë Bujqësore në Landovë 4	Klodian Gashi	Tokë Bujqësore	Qiradhënie Vjetore	ZK Landovë, Prizren	DE 413-2024	0		89,575		€ 1.79		€ 0.10	€ 90.00	1	Refuzim	JO		

MH





Lista e Aseteve për qiradhënie të Aseteve të NSH-ve në Likuidim përmes shpalljes publike e dates 25 shtator 2024

Nr	Rajoni	Emri i NSH-së-njësia	Emri i Ofertuesit me ofertën më të lartë	Uloji i asetit	Qiradhënie Mujore/Vjetore	Vendndodhja e Asetit dhe Komuna	Nr i vendimit të DM mbi themelimin e Komisionit për qira	Sa herë është dhënë me qira?	Cmimi më i lartë i qiradhënies paraprake ose Tenderimit të fundit	Sipërfaqja m²	Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit për m²	Cmimi krahasues në bazë të krahasimeve në Raportet e Vlerësimit për ari	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar m²	Cmimi i ofertës më të lartë të pranuar ari	Cmimi i Ofertës më të lartë	Numri i Ofertave	Vendimet e Bordit	A ka të angazhuar momentalisht sigurim për asetin PO/JO	Shuma mujore e pageses së Sigurimit të asetit	Koment / Vërejtje
1	Gjilan	GJ023 NSH Zanje Bujë	Florentina Salihu	Toka dhe Objektet në Pasjan (brenda sipërfaqes së tokës ndodhen 5 objekte me pajisje të cilat duhet të mbeten/ruhen në objektet ekzistuese) ngjyra 03238-0	Qiradhënie e Mujore	Zona Kadastrale Pasjan, Komuna e Parteshit	DE 400/2024	1	320	1,502.95	0.52		0.59		880	1	Aprovim	PO	1,320	Duke pasur parasysh shpenzimet e sigurimit në vlerë prej 1,320.00€ në baza mujore deri më tani (mundësia e rritjes së shpenzimeve bazuar në vendimin mbi përcaktimin e pages minimale) dhe qiradhënies eventuale në shumë prej 380.00€ do të kishim një ulje të konsiderueshme të shpenzimeve, dhe një ngritje të hyrave nga qiraja si dhe një rritje e vlerës së asetit.
3	Gjilan	GJ028 NSH Agroprodukti GJ027 NSH Zhivko Vasiq	BR Farm Pharm SHPK	20 Objekte/Fermt, objekti administrativ dhe toka e cila ndodhet brenda rrethojave. Palet ngjohen se aseti i ofruar me qira mund të shfrytëzohet vetëm për fermë.	Qiradhënie e Mujore	Zona Kadastrale Ropotov e Madhe dhe Ropotov e Vogël, Komuna e Ranillikut	DE 402/2024	0	1,688	23,250	0.46		0.72		5,111	4	Aprovim	JO		Arsyje për praninë e ofertës është se objektet janë shumë më të demtuara në krahasim me çmimet e objekteve të cilat janë marrë për krahasim, arsyja tjetër është se rrit dhe mbrojt vlerën e aseteve si dhe shton buxhetin e likuidimit në shumë totale 61,332.00 € për 1 vit fiskal.
4	Gjilan	GJ035 NSH Q Agromorava	Labinot Salihu	Toka bujqësore me sipërfaqe prej 77291 m² (7ha 72 ari 91 m²). Pjesa e cila ofrohet për qiradhënie është sipërfaqja prej 6 ha 29 ari 87 m². Përfshihet sipërfaqja prej 14304 m² (1ha 43 ari 04 m², prej qiradhënies objekti i MZI Farm dhe ruget të cilët shfrytësohen nga banorët.	Qiradhënie Vjetore	Zona Kadastrale Viti, Komuna e Vitisë	DE 403/2024	1	502	62,987		1.20		7.94	5,000	4	Aprovim	JO		
12	Gjilan	GJ018 Morava Parteshi	Aleksandar Kostiq	Tokë bujqësore, parcela 01665/G-1K Budnik e Poshtme, sipërfaqja 29134m². Sipërfaqja e cila leshohet me qira është 26742 m², duke përfshirë pjesën e rrethuar brenda fabrikës së NSH Jutoteam.	Qiradhënie Vjetore	Zona Kadastrale Budnik e Poshtme, Komuna e Parteshit	DE 399/2024	0	0	26,742		1.50		1.87	501	1	Aprovim	JO		

174





Nr. Ref. BD-212/2

Në bazë të nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 21 tetor 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet amandamenti i Procedurave të Shitjes me Tender Publik si dhe Shtojcës së Procedurave të Shitjes- Metodologjia e Përcaktimit të Çmimit Orientues, respektivisht shfuqizohen Procedurat e datës 27.09.2023 dhe Metodologjia e 31.08.2022.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Arsyetim

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për amandamentimin e Procedurave të Shitjes me Tender Publik si dhe Shtojcës së Procedurave të Shitjes- Metodologjia e Përcaktimit të Çmimit Orientues.

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktin se gjatë diskutimeve të mëparshme të Bordit është kërkuar që të ndryshohen Metodot e përlogaritjes së çmimit orientues. Andaj për këtë qëllim me datë 24 shtator DE përmes vendimit të evidentuar si 416b-2024 ka themeluar Komisionin për amandamentimin e Procedurave të Shitjes përmes tenderit publik.


Si rrjedhojë, duke u bazuar në udhëzimet e Bordit, janë përgatitur amendamentet me fokus të veçantë në informatat nga dy burime:

- i) Metoda e përlogaritjes së çmimit sipas Zonave të Vlerave dhe Niveleve të Vlerave, të përcaktuara nga Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë, e cila ka prioritet në zbatim dhe
- ii) Metoda e përlogaritjes së çmimit mesatar të shitjeve të realizuara nga AKP brenda tre (3) viteve të fundit e cila gjen zbatim vetëm në rastet kur "Metoda e përlogaritjes së çmimit sipas Zonave të Vlerave dhe Niveleve të Vlerave, të përcaktuara nga Ministria e Financave, Departamenti i Tatimit në Pronë" rezulton me çmime skajshmërisht të ulëta, ose ku nuk ka fare vlerësim të Ministrisë së Financave.

Përfundimisht për asete të veçanta, sipas propozimit të Menaxhmentit dhe miratimit të Bordit, mund të vendoset të bëhet një vlerësim i jashtëm i pavarur (kompani) si burim shtesë i të dhënave për përcaktimin e çmimit orientues

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 21 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-212/3

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) neneve 18.1.3 dhe 18.1.5 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, të cilët ndërlidhen me nenin 2, paragrafi 2.1 i ligjit mbi AKP-në, Neni 3 dhe neni 9.5 dhe 9.6 i Rregullores Nr. 02/2024 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 21 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi i Autoritetit të Likuidimit dhe aprovohet kërkesa për ndryshim të kontratës së qirasë me nr. protokoli 18974/2017 e datës 20/07/2024 e lidhur me qiramarrësin IP-KOS Sh.P.K., ashtu që të lidhet kontrata e qirasë me destinim komercial për ngastrën kadastrale nr. P-01699-8 ZK Llapllasellë me sipërfaqe prej 3984 m2 me çmimin prej 612.00 Euro/muaj për pronën e NSh "Ratar" PRN115.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Autoritetit të Likuidimit për ndryshimin e kontratës të qirasë sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si ne vijim:

Kontrata e qirasë me nr. protokoli 18974/2017 është lidhur më datë 20/07/2017 në mes të Autoritetit të Likuidimit të NSh "Ratar" dhe qiramarrësit IP-KOS Sh.P.K. për ngastrën kadastrale P-1699-8 e cila në bazë të kontratës së qirasë është shfrytëzuar si tokë bujqësore. Kjo parcelë është dhënë me qira përmes tenderit publik, për sipërfaqen prej 4574 m2 në shumën prej 567.00 për një vit kalendarik. Kjo kontratë e qirasë është vazhduar me aneks kontratën e qirasë me nr. protokoli 48076/2023 më datë 01.08.2023.

Më datë 17 korrik 2024, Autoriteti i Likuidimit ka pranuar e-mail nga Zyrtarja e Rastit e cila ka realizuar vizitë në terren, ku ka konstatuar që një pjesë e parkingut e parcelës shfrytëzohet si parking dhe një pjesë tjetër rrugë.

Duke qenë se aset i ka ndryshuar destinimin kohëve të fundit në bazë të deklaratimit nga ana e zyrtares së rastit, i cili ndryshim do duhej të ishte bërë në përshtatshmëri me nenin 2.2 të kontratës së qirasë, ashtu që për ndryshimin e destinimit do të duhej të ishte marrë pëlqimi me shkrim nga ana e Autoritetit të Likuidimit të NSh "Ratar" në cilësinë e qiradhënësit.

Për këtë arsye, fillimisht palët janë ftuar në takim dhe më pastaj ju është dërguar një njoftim me shkrim me nr. protokoli 52988/2024 më datë 28.08.2024, ku janë njoftuar që pasi që kontrata e qirasë ka skaduar me datë 31/07/2024 e njëjta nuk mund të vazhdohet me të njëjtat kushte, sepse si rrjedhojë e ndryshimit të destinimit të parcelës në fjalë atëherë ndryshon edhe çmimi dhe kemi kërkuar nga të njëjtit që brenda afatit prej 15 ditësh të deklarohen në lidhje me këtë njoftim ose të bëjnë lirimin e parcelës. Më datë 28.08.2024 përfaqësuesi i IP KOS Sh.P.K. ka dërguar e-mail ku i njëjti edhe sipas takimit ka paraqitur si kërkesë dhe propozim që të vazhdojnë kontratën e qirasë me destinimin i cili do të përcaktohet nga ana e qiradhënësit edhe pse të njëjtit pretendojnë që vetëm një pjesë e parcelës shfrytëzohet si rrugë.

Duke u bazuar në nenin 2.2 të kontratës së qirasë, ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore duhet të bëhet vetëm me pëlqimin me shkrim nga ana e qiradhënësit, mirëpo pasi që në këtë rast pas ndryshimit të destinimit duhet të ndryshohet dhe aprovohet çmimi i ri i qirasë.

MH



Në këtë rast ndryshimi i destinimit do të bëhet nga ai për shfrytëzimin e parcelës P-01699-8 ZK Llapllasellë si tokë bujqësore në destinim komercial, e që të njëjtën qiramarrësi e shfrytëzon për parking.


Po ashtu, edhe të hyrat nga lëshimi me qira i parcelës në këtë rast do të rriten për arsye se nga çmimi që ishte prej 567.00 Euro për një vit kalendarik, atëherë do të duhet të paguajë qiramarrësi shumë prej 612.00 Euro për muaj, në bazë të çmimit të përcaktuar nga ana e komisionit vlerësues për përcaktimin e çmimit. Pjesë e parcelës P-01699-8 ZK Llapllasellë është edhe sipërfaqja prej 590 m² e cila shërben si rrugë, konkretisht nëpër këtë kalon magjistralla Prishtinë-Ferizaj dhe kështu kjo sipërfaqe do të i largohet nga pjesa e qirasë dhe për qiradhënie do të i llogaritet vetëm sipërfaqja prej 3984 m².

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 21 tetor 2024



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-212/4

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Paragrafit 3.33 i dosjes së tenderit, Nenit 14.1 të kontratës me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 respektivisht të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) ashtu siç specifikohet në nenin 6 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 21 tetor 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve të Agjencisë aprovon Raportin e kontraktorit për punën 5 (pesë) vjeçare nga data 1 korrik 2019 - 30 qershor 2024.
- II. Autorizohen Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtori i D. Prokurim që të nënshkruajnë Çertifikatën për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale” të paraparë në nenin 14.1 të Kushteve të Veçanta të Kontratës ndërmjet AKP-së dhe konsorciumit “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle” LLP, “Grant Thornton Consulting” Doo dhe “Grant Thornton” L.L.C.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Komitetit Drejtues të Likuidimit për aprovimin e raportit 5 (pesë) vjeçar për kontratën e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore dhe autorizimi për Kryesuesin e Bordit të Drejtorëve për Lëshimin e Certifikatës së Kompletimit

Ky vendim është aprovuar duke pas parasysh faktet si në vijim:

Në dhjetor 2018 AKP-ja kishte shpallur tender publik ndërkombëtar për angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve Profesionale (OSHP) për Likuidimin e portofolios së Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë. Kontrata me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 ishte nënshkruar me datë 28 qershor 2019 në mes të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe kontraktorit/konsorciumit “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle” LLP, “Grant Thornton Consulting” Doo dhe “Grant Thornton” L.L.C. për Ofrues të Shërbimeve Profesionale në projektin e likuidimit të portofolios së NSH-ve në territorin e Kosovës.

Kohëzgjatja e kësaj kontrate ishte 5 (pesë) vjet duke filluar nga 1 korrik 2019 për të përfunduar me 30 qershor 2024. Deri në përfundimin e kësaj kontrate për 513 NSH kishin filluar procedurat e Likuidimit.

Veprimet e ndërmarra deri më tani:

Menaxheri i Projektit ka përgatitur një raport të bashkangjitur këtij memorandum duke përfshirë aspektet kryesore të projektit të Likuidimit:

- Vendorsja në procedurë të likuidimit dhe emërimi i Autoriteteve të Likuidimi për 78 NSH;
- Shqyrtimi i kërkesave kreditore dhe lëshimi i vendimeve nga AL-të, 3,641 vendime të AL-ve;
- Numri i NSH-ve për të cilat është përmbyllur procesi i likuidimit - 11 NSH të mbyllura nga kontraktori;
- Raportet vjetore të kontraktorit (raportet vjetore të OSHP-së dhe raportet vjetore të likuidimit të NSH-ve) për periudhën nga 1 korrik 2019 deri më 30 qershor 2024;





- Raportet për Shpërndarjen Përfundimtare, Raporte Përfundimtare dhe të Pjesshme, Raporte të Përkohshme, Raporte të Përkohshme dhe të Pjesshme, Raporte Shtesë të Përkohshme dhe Raporte Shtesë të Përkohshme dhe të Pjesshme;
- Raportet për heqje dorë të aseteve të dorëzuara në Bordin e Drejtorëve dhe në DhPGJSK;
- Pasqyrimi i pagesave ndaj kontraktorit;
- Sfidat me të cilat është përballur OShP-ja në procesin e likuidimit deri më 30 qershor 2024.


Komiteti Drejtues i Likuidimit (KDL) ka mbajtur mbledhje dhe ka shqyrtuar raportin 5 (pesë) vjeçar të kontraktorit.

Vështirësitë dhe pengesat kryesore gjatë zbatimit të kontratës:

Duhet theksuar se OShP nuk ishte në gjendje që të përmbush të gjitha objektivat kontraktuale për arsye si në vijim:

1. Trajtimi i aseteve jashtë vendit:
 - Pamundësia për të shitur ose hequr dorë nga asete të caktuara jashtë vendit për arsye të ndryshme, si p.sh., vendimet e autoriteteve publike të vendit ku ndodhen asetet, çështjet që kanë të bëjnë me uzurpimin e këtyre aseteve, vështirësitë në qasjen në objektet e aseteve që ndodhen jashtë vendit, mund të jenë pengesë e madhe për përfundimin sa më efikas të procesit të likuidimit.
2. Shpronësimet e aseteve:
 - AL-të janë në dijeni që shpronësimet e aseteve në Kosovë nuk trajtohen nga AKP-ja, por nga organet e tjera administrative. Prandaj, AL-të nuk kanë kontroll mbi mënyrën se si adresohen këto çështje. Për hir të një procesi sa më efikas dhe në kohë të likuidimit, është e rëndësishme që procedurat e shpronësimit dhe çdo çështje dhe pretendim i mundshëm i tyre të trajtohen me kohë nga autoritetet kompetente administrative.
3. Çështjet kadastrale
 - Një pengesë tjetër për shitjen efikase të aseteve të NSh-ve janë çështje të caktuara kadastrale, që kryesisht vijnë nga mungesa e të dhënave kadastrale dhe mundësia për të marrë të dhëna të tilla nga shtetet fqinje. Ndër pasojat e mundshme të këtyre çështjeve janë vështirësitë në përcaktimin e pronarit aktual të një ngastre të tokës dhe/ose kufijve aktualë të pasurisë së tillë. Këto pengesa, mund të kenë ndikim negativ në përshpejtimin e procesit të likuidimit, pasi, pa u zgjidhur çështjet e tilla, është e vështirë që AL-të të aprovjnë shitjen/heqjen dorë të aseteve në fjalë.
4. Informatat dhe dokumentet nga DhPGJSK
 - Para mbylljes së likuidimit të NSh-së, nga DhPGJSK-ja kërkohet konfirmimi se nuk ka lëndë të pazgjidhura në lidhje me NSh-në në fjalë. Mungesa e informacioneve rreth gjendjes së lëndëve të pazgjidhura mund të shkaktojë vonesa të mundshme.
5. Vendimet në pritje pranë Gjykatave Themelore
 - OShP-ja është informuar se disa lëndë në lidhje me qiratë e papaguara dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme në favor të AL-ve aktualisht janë në pritje përpara Gjykatave Themelore të Republikës së Kosovës. Mundësia e rasteve të tilla që marrin disa vite për t'u vendosur mund të përbëjë pengesë për mbylljen e likuidimit, veçanërisht të atyre likuidimeve, kur kërkesat e aprovuara të kreditorëve nuk mund të përmbushen plotësisht. Sidoqoftë, sa herë që fondet e likuidimit janë të mjaftueshme për të përmbushur plotësisht kërkesat e aprovuara të kreditorëve, fondet tepriçë do t'i shpërndahen Qeverisë.
6. Vonesat në marrjen e informacioneve nga DhPGJSK-ja
 - OShP-ja, gjatë periudhës nga 1 gusht 2019 deri më 30 qershor 2024, është ballafaquar me disa vonesa të konsiderueshme në marrjen e informacioneve nga DhPGJSK-ja. Kjo rrethanë është një faktor i jashtëm që ka ngadalësuar aktivitetet e grumbullimit dhe përpunimit të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për vlerësimin e kërkesave dhe analizën e

MH



shpërndarjes, gjë që, nëse do vazhdojë kështu, mund të ndikojë në efektivitetin e punës së OShP-së.

Komiteti Drejtues i Likuidimit ka njoftuar Bordin se konsideron se Kontraktori ka përmbushur objektivat kryesore të dala nga kontrata të cilat kanë qenë nën kontrollin e OShP-së, prandaj thekson se Raporti 5 (pesë) vjeçar i dorëzuar në shtojcë të këtij memorandum paraqet informata të mjaftueshme për të marrë vendim të informuar.

Me anë të lëshimit të Certifikatë për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale” lirohet edhe depozita e sigurimit të performancës së kontratës. Kjo certifikatë lëshohet duke u bazuar në neni 14.1 të kontratës me numër identifikues 239-18-9399-2-1-1 respektivisht të Kushteve të Veçanta të Kontratës (KVK) ashtu siç specifikohet në nenin 6 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK): ...”Certifikata e Kompletimit duhet të lëshohet nga Kryesuesi i Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në ditën e kompletimit ashtu siç specifikohet nga neni 6 KPK” si dhe për aprovimin e raportit 5 (pesë) vjeçar: paragrafi 3.33 i dosjes së tenderit të kontratës.

Duke u bazuar në ato që u thanë më sipër, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 21 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-212/5

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115) Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën 21 tetor 2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i Drejtorëve autorizon z. Albert Muja-Udhëheqës i Ekipit për Likuidim, Zyra Rajonale Mitrovicë, që të veprojë në emër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si Administratore e Ligjshme e N.Sh. "Trepça - Ndërmarrje nën Administrim të AKP me numër unik të identifikimit: 810356932 dhe të veprojë për ndërmarrjen, me të drejtat dhe autorizimet si në vijim:
- i) Të aplikojë, dorëzojë, rregullojë dhe tërheq dokumente dhe vërtetime të ndryshme pranë të gjitha organeve kompetente publike dhe private në Republikën e Kosovës;
 - ii) Të bëjë transferimin e llogarive dhe mjeteve financiare që mund të jenë në llogaritë bankare të NSH-së në fjalë tek Trepça SH.A. (NUI: 811278747) pranë të gjitha bankave komerciale në Kosovë, pa asnjë kufizim, pranë të gjitha bankave komerciale në Kosovë;
 - iii) Të bëjë aplikimin dhe tërheqjen e fletave poseduese, kopjet e planit si dhe vërtetimet për tatim në pronë për të gjitha pronat të cilat evidentohen në emër të NSH-së në fjalë.
 - iv) Pranë organeve kompetente të Republikës së Kosovës, duke përfshirë por mos u kufizuar në Gjykata, Komuna, Policinë, Administratën Tatimore, Zyre Noteriale, KEDS, Ujësjiellës, kompanitë e pastrimit dhe mbeturinave, postave dhe të tjera, dhe të ndërmarr çfarëdo lloj veprimi për kryerjen e shërbimeve administrative.
- II. Autorizohet Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të nënshkruajë autorizimin e mësipërm, si dhe dokumente tjera që mund të jenë të nevojshme të nënshkruhen, për ndërmarrjen e veprimeve eventuale, që ndërlidhen me statutin e NSh Trepça, apo çfarëdo veprimi eventuale pranë organeve kompetente që kërkon autorizim të veprohet për dhe në emër të NSh Trepça Ndërmarrje në Administrim të AKP-së.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin lidhur me dhënien e Autorizimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit për çështje të veprimeve Administrative ndaj "N.Sh. "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP".

Ky vendim u aprovua duke u bazuar në faktet si në vijim:

Me datë 31 tetor 2016 ka hyrë në fuqi i Ligji Nr. 05 L 120 për Trepçën, i cili themelon Ndërmarrjen Publike "Trepça ShA", e cila bazuar në statusin e saj, do të menaxhojë me të gjitha asetet thelbësore/fitimprurëse të ish N.Sh. Trepçës. Asetet e mbetura nga NSh Trepça – të definuara si asetet jothelbësore/jofitimprurëse, bazuar në Ligjin për Trepçën, mbesin nën menaxhim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Me datë 03 shkurt 2019 është miratuar Statuti i Trepça Sh.A në Kuvendin e Kosovës.

Me datë 08 mars 2019 është bërë regjistrimi në ARBK i Trepça Sh.A.

Me datë 21 mars 2019, Bordit të AKP iu është dërguar kërkesa nga Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh.A, për transferim të autorizimeve ndaj të gjitha llogarive bankare të NSh. Trepça.



Me datë 25 prill 2019, Bordi i AKP-së ka marrë vendim për miratim të kërkesës së Trepça Sh.A. të datës 21 mars 2019, dhe ka autorizuar Drejtorin Menaxhues për transferimin të gjitha llogarive bankare, nga "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" tek "Trepça" Sh.A. Me udhëzim të Bordit të Drejtorëve të AKP, Drejtori Menaxhues i AKP-së, ka dorëzuar shkresa zyrtare tek institucionet relevante dhe i ka njoftuar me vendimin e Bordit për transferimin e autorizimeve në llogaritë bankare të Trepçës, nga AKP tek Sh.A. "Trepça". Në vitin 2019, Bordi i AKP nuk ka paraparë si të rrugës ndërmarrjen e veprimeve për ndryshim të autorizimeve në ARBK.

Bazuar në faktin se Certifikata e Biznesit e "Trepça NSH" pranë ARBK ende figuron aktive, në mënyrë që të jenë të azhurnuara këto të dhëna deri në definimin e statusit të Njësive jo thelbësore, dhe në rast të nevojës për ndërmarrje të çfarëdo veprimi tjetër për NSH Trepça, është vlerësuar se duhet të caktohen/azhurnohen autorizimet në fjalë.

Meqenëse me Ristrukturimin e Agjencisë me fillim në 01.10.2023 ka pushuar së vepruari Njësia e Trepçës, dhe lëndët e ish NSH Trepça janë përcjellë tek Zyra Regjionale Mitrovicë, Bordi vlerëson se zyrtari i autorizuar, duhet të jetë nga radhët e kësaj zyre regjionale, si rrjedhojë propozohet të autorizohet z. Albert Muja, - Udhëheqës i Ekipit të Likuidim i cili njëkohësisht ka qenë edhe zyrtar përgjegjës për përgatitjen e Kërkesave për Përcaktim të Statuseve për njësit jo thelbësore të cilat pritet të jene nën administrim të AKP pas përcaktimit të statusit të tyre nga njësia përkatëse brenda AKP-së.

Bordi po ashtu vlerëson se duhet të Autorizohet Kryesuesi i Bordit të nënshkruajë autorizimin e mësipërm, si dhe dokumente tjera që mund të jenë të nevojshme të nënshkruhen më vonë për marrjen e veprimeve për ndërrimin e personit të autorizuar në ARBK.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 21 tetor 2024


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vendimi me numër të referencës: **BD-212/6**

Vërejtje:

Ky Vendim nuk është publikuar për shkak se ka të bëjë me çështje të brendshme, qoftë organizative apo procedurale të Agjencisë dhe përmban informacione të individëve të caktuar që mund të bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Ligji 03/L-172).

Agjencia ju njofton se në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (L-03/L-215), palët e interesuara mund të parashtrojnë kërkesë specifike me arsyetim përkatës për qasje në këto Vendime tek Zyrtari përgjegjës për Qasje në Dokumente Publike.